



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:110514

Datë: 23.10.2020

Numri i dokumentit: 01214105

**PKR.nr.107/2020**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**- Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues – gjyqtarit Agim Ademi, me zyrtaren ligjore Adelina Brestovci, në lëndën penale kundër të akuzuarve A.Z. nga fshati Gjylekar, K.Vitisë, me mbrojtësin e tij av.Hamdi Jashari nga Gjilani, i akuzuari F.I. nga fshati Gjylekar, K.Vitisë, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.Ymer Huruglica nga Gjilani, dhe i akuzuari dhe A.S. nga fshati Gjylekar, K.Vitisë, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.Skender Shefkiu nga Vitia, për shkak të veprës penale kontrabandim me migrantë në tentativë nga neni 164. Par.1, lidhur me nenin 20 dhe 31, të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr. 110/2020, të datës: 25.09.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datë: 21.10.2020, bie dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli këtë :

### **A K T G J Y K I M**

#### **Të akuzuarit:**

**I.** A.Z. nga i ati Z. dhe nëna R., e lindur Ismajli, i lindur me datë ..., në fshatin Gjylekarë, K.Vitisë, ku edhe jeton, i pa martuar, i punësuar në ndërmarrjen ..., a të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar Shtetas i R. së Kosovës, me numër personal: ....

**II.** F.I., nga i ati K. dhe nëna E., e lindur Q., i lindur me datë ..., në fshatin Gjylekarë, K.Vitisë, ku edhe jeton, i martuar, baba i tre fëmijëve pronar i ndërmarrjes ..., a të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar Shtetas i R. së Kosovës, me numër personal:....

**III.** A.S., nga i ati M dhe nëna S., e lindur H. , i lindur me datë ..., në Viti, me vendbanim në fshatin Gjylekarë, K.Viti, i pa martuar, i papunësuar, ka të mbaruar

Psikologjinë, Niveli Bachelor, në kolegjin “Fama”, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar Shtetas i R. së Kosovës, me numër personal:...

## JANË FAJTOR

Se me datë ..., rreth orës 21:15 min, në pikën kufitare Dheu i Bardhë, të pandehurit në bashkëveprim dhe me dashje kanë tentuar ti transportojnë të dëmtuarit; M.O. e H.H. për në shtetet e Be, ku fillimisht të pandehurit takohen në kafiterinë “ Leo”, e cila gjendet në qendrën tregtare “Interex”, në Viti, ku bisedojnë , koordinojnë veprimet e tyre, ashtu që fillimisht i pandehuri F.I. niset me veturën e tij për në drejtim të Bujanovcit, me qëllim që ti pres të dëmtuarit atje, e më pas nisen të pandehurit : A. dhe A.1. dhe të dëmtuarit , me veturën e të pandehurit Arsim, të markës “VË Polo”, ngjyrë hiri me tab . regj. ..., me qëllim përfitimi, të njëjtit për ti transportuar të dëmtuarit dhe e kanë ditur se nuk janë të pajisur me dokumentacion valid, me qëllim që ti transportojnë jashtë vendit dhe se të njëjtit paraprakisht janë marrë vesh në mënyrën e kryerjes dhe përfitimit duke premtuar se posa të arrijnë në Gjermani, t’ua paguajnë shumën prej 4.700 €, për person gjithsejt 9.400 €, dhe me rastin e kontrollimit në pikën kufitare Dheu i Bardhë gjatë identifikimit dhe legjitimitetit është konstatuar se të pandehurit kanë pasë qëllim që ti transportojnë të dëmtuarit M.O. dhe H.H. për në shtetet tjera të BE- në Gjermani.

-Me çka në bashkëveprim kanë kryer veprën penale Kontabandimi me migrantë në tentativë nga neni 164, par.1, lidhur me nenin 20 dhe 31, të KPRK-së

Andaj, gjykata në bazë të neneve 7, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 44, 71, 72, 79, 107, dhe të KPRK si dhe neneve 365 dhe 453 të KPPRK-ës.

## I DËNON

**1. Të akuzuarin A.Z.**, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, dhe dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, në dënimin e shqiptuar me burgim do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 07.09.2020 deri me datë 21.10.2020. Pjesa e mbetur e dënimit me burgim, prej 136 ditëve me propozimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij i shndërrohet në dënim me gjobë në shumë prej 2500 €. Me zbatim të dispozitave për dënimin unik, të njëjtit i shqiptohet dënim unik me gjobë në shumë prej 3000 €.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin e caktuar me gjobë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, atëherë dënimi me gjobë do t’i zëvendësohet me dënim burgu, duke ia llogaritur nga 20 € për një ditë burgimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 40 (katërdhjetë) euro, si dhe 50 (euro) për kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës.

**2.Të akuzuarin F.I.**, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, dhe dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, në dënimin e shqiptuar me burgim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 07.09.2020 deri me datë 21.10.2020. Pjesa e mbetur e dënimit me burgim, prej 136 ditëve me propozimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij i shndërrohet në dënim me gjobë në shumë prej 2500 €. Me zbatim të dispozitave për dënimin unik, të njëjtit i shqiptohet dënim unik me gjobë në shumë prej 3000 €.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin e caktuar me gjobë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu, duke ia llogaritur nga 20 € për një ditë burgimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 40 (katërdhjetë) euro, si dhe 50 (euro) për kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës.

Të akuzuarin A.S., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, dhe dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, në dënimin e shqiptuar me burgim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 07.09.2020 deri me datë 21.10.2020. Pjesa e mbetur e dënimit me burgim, prej 136 ditëve me propozimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij i shndërrohet në dënim me gjobë në shumë prej 2500 €. Me zbatim të dispozitave për dënimin unik, të njëjtit i shqiptohet dënim unik me gjobë në shumë prej 3000 €.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin e caktuar me gjobë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu, duke ia llogaritur nga 20 € për një ditë burgimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 40 (katërdhjetë) euro, si dhe 50 (euro) për kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda ka paraqitur aktakuzë PP.I.nr. 110/2020, të datës: 25.09.2020, kundër të akuzuarve A.Z. nga fshati Gjylekar, F.I. dhe A.S., që të tre nga fshati Gjylekar, K.Vitisë, për shkak të veprës penale kontrabandim me migrantë në tentativë nga neni 164. Par.1, lidhur me nenin 20 dhe 31, të KPRK-ës dhe ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritore sipas ligjit.

**Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda Agron Uka**, mbeti pranë aktakuzës, duke shtuar se nga provat e grumbulluara gjatë

fazës së hetuesisë, e të cilat i janë bashkëngjitur shkresave të lëndës, është vërtetuar se të akuzuarit A.Z., F.I. dhe A.S, e kanë kryer veprën penale kontrabandim me migrantë në tentativë nga neni 164. Par.1, lidhur me nenin 20 dhe 31, të KPRK-ës.

Se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale, vërtetohet edhe me pranimin e fajësisë, në shqyrtimin fillestar. Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, i propozojmë gjykatës që të merr parasysh sikurse rrethanat rënduese, po ashtu edhe rrethanat lehtësuese.

Si rrethanë rënduese duhet të merret fakti se vepra penale është e natyrës së rëndë si dhe faktin që vepra është kryer në kohën e pandemisë, e cila është shtrirë në kudo në Evropë por edhe në Botë dhe me kalimin e kufirit në mënyrë ilegale do të rrezikohet jeta e njerëzve, sikurse ka qenë rasti me tragjedinë në lumin Tisa, me rastin e kalimit të kufirit.

Si rrethana lehtësuese duhet të merren parasysh pendimin e thellë të akuzuarve, premtimin e tyre se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra penale, shprehjen e keqardhjes së thellë, si dhe kërkim falja ndaj të dëmtuarve si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, në mënyrë që të njëjtëve të iu shqiptoj një dënim në suaza të ligjit, në mënyrë që do të ndikonte pozitivisht në riintegrimin e të njëjtëve në shoqëri dhe nuk do të përsërisnin vepra penale.

**Mbrojtësi i të akuzuarit A.Z., me autorizim zëvendësues të av.Hamdi Jashari, av.Fitim Kosumi**, sa i përket dënimit shtoi se ndaj të mbrojturit tim i propozojmë gjykatës që t'i shqiptohet një dënim sa më i butë, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese, siç janë: se është hera e parë që i akuzuari A.Z., ka rënë në kundërshtim me ligjin, se i njëjti është penduar për veprën e kryer penale, se i njëjti e ka pranuar fajësinë që nga intervistimi i parë në polici, po ashtu edhe premtimin e të njëjtit se në të ardhmen do të jetë shumë më i kujdesshëm, në mënyrë që të mos përsëris vepra tjera të ngjashme, apo vepra tjera. Andaj kërkojmë nga gjykata që të mbrojturit tim t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.

**I akuzuari A.Z.**, fillimisht e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë, derisa në deklarin lidhur me dënimin, i njëjti shtoi se kam gabuar me rastin e kryerjes së veprës penale, premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris ndonjë vepër të ngjashme apo tjetër, është hera e parë që kam rënë në kundërshtim me ligjin, i propozoj gjykatës të shqiptoj një dënim më të butë, e mundësisht dënim me gjobë.

**Mbrojtësi i të akuzuarit F.I., avokat Ymer Huruglica**, deklaroi meqenëse i akuzuari F.I. e ka pranuar fajësinë, i propozoj gjykatës, që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, t'i ketë parasysh një varg rrethanash lehtësuese në mënyrë që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë.

Rrethana veçanërisht lehtësuese është se i njëjti e ka pranuar fajësinë, por edhe fakti që vepra penale ka mbetur në tentativë, çka do të thotë që dënimi mund të zbutet.

Andaj, i propozojmë gjykatës që në kuptim të nenit 71, par.3, KPRK-së, duke qenë se i njëjti e ka pranuar fajësinë, t'i shqiptohet një dënim më i butë, derisa bazuar në nenin 72, par.1, pika 1.4, të KPRK-së, dënimi mund t'i zbutet deri në gjashtë muaj.

Po ashtu si rrethanë lehtësuese të merret edhe fakti që i akuzuari ka psë një rol-kontribut të vogël në kryerjen e veprës penale, është njeri familjar, mbajtës i familjes, se të dëmtuarit nuk kanë paraqitur kërkesë pasurore juridike. I akuzuari pos tjerash ka pasë sjellje të mira në gjykatë, në veçanti pendimi i tij për kryerjen e veprës penale. Andaj, i propozoj gjykatës që të mbrojturit tim t'i shqiptoj një dënim me gjobë, sa më të ulët, derisa nëse gjykata i shqipton dënim me burgim deri në gjashtë muaj, dënimin me burgim t'i zëvendësohet me gjobë.

**I akuzuari F.I.** në seancën për shqyrtim fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, derisa në deklarin lidhur me dënimin shtoi se më vie keq për veprën e kryer penale, jam mbikqyrës i familjes, pendohem për veprimet e ndërmarra, i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale. Andaj, propozoj që të më shqiptohet një dënim më i butë.

**Mbrojtësi i të akuzuarit A.S, avokat Skender Shefkiu,** në deklarin lidhur me dënimin shtoi se i mbrojturi im edhe në shqyrtimin e kaluar fillestar, por edhe sot, e ka pranuar veprën penale e cila i vihet në barrë. Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, i propozojmë gjykatës që të ketë parasysh rrethanat lehtësuese se: i mbrojturi im asnjëherë më parë nuk ka ra ndesh me ligjin, duke e pasë parasysh nivelin e tij të shkollimit, i njëjti e ka përjetuar shumë rëndë ngjarjen, duke konsideruar se me këtë atk “ ia kam marrë fytyrën familjes”. Andaj, kërkojmë nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit të njëjtit t’i shqiptoj një dënim më të butë, dhe duke qenë se vepra penale është e ndëshkueshme me dënim me gjobë dhe me burgim, propozojmë që dënimin me burgim t’ia shndërroj në dënim me gjobë, e duke e pasë parasysh që vepra ka mbetur ne tentativë dhe fatmirësisht nuk ka pasë pasoja. Po ashtu duhet të merret parasysh edhe fakti se i mbrojturi im më parë nuk ka kryer vepër penale.

**I akuzuari A.S,** fillimisht e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe më pas duke u pajtuar plotësisht me deklarin e mbrojtësit të tij, shtoi se pendohem thellësisht për veprën e kryer penale, premtoi se asnjëherë tjetër nuk do të kryej vepra tjera penale, i kërkoj falje të dëmtuarve, andaj, i propozoj gjykatës që të më shqiptoj një dënim më të butë, mundësisht me gjobë dhe me kusht.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe atë: raporti fillestar i incidentit, deklaratat e të dëmtuarve H.H. dhe M.O., të dhëna në prokurorinë e Shtetit me datë 22.09.2020, deklaratat e të akuzuarve A.Z., Faton Osmani dhe A.S po ashtu të dhëna në Prokurorinë e Shtetit me datë 17.09.2020, si dhe fotodokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, e po ashtu edhe pranimi i fajësisë nga të akuzuarit në seancën e shqyrtimit fillestar, ashtu që vërtetoi se të akuzuarit A.Z., Faton Osmani dhe A.S, me datë 07.09.2020, rreth orës 21:15 min, në pikën kufitare Dheu i Bardhë, të njëjtit në bashkëveprim dhe me dashje kanë tentuar ti transportojnë të dëmtuarit; M.O. e H.H. për në shtetet e Be, ku fillimisht të pandehurit takohen në kafiterinë “ Leo”, e cila gjendet në qendrën tregtare “Interex”, në Viti, ku bisedojnë , koordinojnë veprimet e tyre, ashtu që fillimisht i pandehuri F.I. nisat me veturën e tij për në drejtim të Bujanovcit, me qëllim që ti pres të dëmtuarit atje, e më pas nisen të pandehurit : Arsim dhe Arbnor dhe të dëmtuarit , me veturën e të pandehurit Arsim, të markës “VË Polo”, ngjyrë hiri me tab . regj. 06-259-CL, me qëllim përfitimi, të njëjtit për ti transportuar të dëmtuarit dhe e kanë ditur se nuk janë të pajisur me dokumentacion valid, me qëllim që ti transportojnë jashtë vendit dhe se të njëjtit paraprakisht janë marrë vesh në mënyrën e kryerjes dhe përfitimit duke premtuar se posa të arrijnë në Gjermani, t’ua paguajnë shumën prej 4.700 €, për person gjithsejt 9.400 €, dhe me rastin e kontrollimit në pikën kufitare Dheu i Bardhë gjatë identifikimit dhe legjitimitimit është konstatuar se të pandehurit kanë pasë qëllim që ti transportojnë të dëmtuarit M.O. dhe H.H. për në shtetet tjera të BE- në Gjermani dhe në këtë mënyrë e kanë kryer veprën penale kontrabandim me migrantë në tentativë nga neni 164. Par.1, lidhur me nenin 20 dhe 31, të KPRK-ës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 69 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se të akuzuarit janë penduar për kryerjen e veprës penale, se kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryerjnë vepra tjera penale, se kanë shprehur keqardhje duke iu kërkuar falje të dëmtuarve, dhe faktin se të akuzuarit A.Z. dhe A.S, më parë nuk kanë qenë të gjykuar. Si rrethanët veçanërisht lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë, që në fazën e hetuesisë nga ana e të akuzuarve A.Z. dhe F.I..

Ndërsa si rrethanë rënduese është marrë rrezikshmëria e lartë shoqërore e kësaj vepre penale, dhe fakti që veprat e tilla janë një dukuri e shpeshtë.

Në prezencë të rrethanave të shumta lehtësuese, e pranimit të fajësisë si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të akuzuarit, gjykata të njëjtëve u ka shqiptuar dënim me burgim nën minimumin e paraparë ligjor, duke u bazuar në nenet 71 dhe 72, të KPRK-së, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës. , në mënyrë që t'i prandaoh kryesit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloh personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK-së.  
Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**  
**PKR.nr. 107/2020 Me datë.21.10.2020**

**Zyrtare ligjore**  
Adelina Brestovci

**Kryetari i trupit gjykues**  
Agim Ademi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Krimeve të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.